**37. Administrata e QKUK - SHSKUK-së**
**Hyrja kryesore e objektitDuhet të ketë sigurim fizik 8 ore**
**(Sigurim fizik 8 orë)**

FS **Financat Security Code**
Kjo pike roje nenkupton sigurim ç'dite 8 ore pune *30.50 dite ne muaj

FS **Financat Security Code**
Kjo pike roje nenkupton sigurim ç'dite 8 ore pune *30.50 dite ne muaj

FS **Financat Security Code**
Kjo pike roje nenkupton sigurim ç'dite 8 ore pune *30.50 dite ne muaj

FS **Financat Security Code**
Kjo pike roje nenkupton sigurim ç'dite 8 ore pune *30.50 dite ne muaj

FS **Financat Security Code**
Kjo pike roje nenkupton sigurim ç'dite 8 ore pune *30.50 dite ne muaj

FS **Financat Security Code**
Kjo pike roje nenkupton sigurim ç'dite 8 ore pune *30.50 dite ne muaj

AK nuk ka vlerësuar me kujdes ofertën e dorëzuar, ndërsa Komisioni gjatë procesit të vlerësimit, me ose pa dashje, ka pranuar një analizë financiare nga OE i shpallur fitues, e cila nuk e ka të pasqyruar çmimin sipas kërkesave të DT-së, pasi në analizë nuk janë shpërndarë orët e punës sipas pozicioneve të kërkuara në specifikimet teknike. Për pasojë, OE i shpallur fitues ka kalkuluar gabimisht të gjitha vendrojet 8 orë në ditë, duke i kalkuluar vetëm për ditët e punës.

OE i shpallur fitues, sipas analizës financiare të ofruar, ka kalkuluar në kundërshtim me Ligjin e Punës edhe pozicionet e orëve të natës (shih Tabelën 1, pozicioni 2 – orët e natës). Po ashtu, ka konstatuar në mënyrë të gabuar numrin e punëtorëve prej 147 punëtorësh (shih Tabelën 1, pozicioni 11 – Totali pa TVSH për 147 punëtorë).

Çmimi i ofertës mujore me TVSH, sipas analizës së paraqitur në Tabelën 1, nuk i mbulon kërkesat e DT-së dhe, rrjedhimisht, është i papërgjegjshëm, sepse nuk mbulon pagat për punëtorët të cilët duhet të angazhohen në 38 vendroje 24 orë, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DT.

**Provë:** Analiza financiare e OE të shpallur fitues, ku janë hijezuar pozicionet e kalkuluara gabimisht dhe në kundërshtim me kërkesat e DT-së.

Nga kjo shihet në mënyrë të qartë se AK ka shpallur fitues një ofertë e cila bie ndesh dhe është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik.

Prandaj, ky pretendim ankimor duhet të konsiderohet i bazuar dhe kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues pranë OSHP-së që ta trajtojë si ofertë të papërgjegjshme ofertën e shpallur fituese në këtë aktivitet.

Në bazë të analizës financiare të detajuar sipas të gjitha pozicioneve, çdo ofertë nën pragun:
4.61 € për orë me TVSH duhet të trajtohet si ofertë potencialisht anormalisht e ulët dhe t'i nënshtrohet verifikimit të plotë financiar dhe ligjor nga Autoriteti Kontraktues.
Në mungesë të një justifikimi të plotë, të dokumentuar dhe të verifikueshëm, një ofertë e tillë nuk mund të konsiderohet ekonomikisht e përgjegjshme dhe nuk garanton realizimin e kontratës sipas kërkesave ligjore në fuqi.
Ne vijim Analize sipas Kerkesave te DT:

| **TABELA I Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve per punetoret 24 ore** | Vlera | Periudha |
|---|---|---|
| Paga Bruto 500.00 euro /176 = 2.84 euro per nje ore pune te rregullt | 500.00 | Mujore |
| 59 Orët e natës 30% (2.84*30%=0.85 euro ) | 50.15 | Mujore |
| 6 Orët e festive 50% (2.84*50%=1.42 euro ) | 8.52 | Mujore |
| Pushimi vjetor 20 ditë pune(reference ligji I punes 20 dite *8 ore =160 ore ne muaj *2.84euro =454.40 euro / 12 muaj =37.87 | 37.87 | Mujore |
| 52 Ore vikendi * 50%(8.66 dite mesatare ne vikend * 24 =208 ore ne muaj /4 punetor = 52 ore 1.42euro=73.84 euro ne muaj | 73.84 | Mujore |
| Totali i shpenzimeve Bruto për një punëtor | 670.38 | Mujore |
| Trusti pensional 5% i punëdhënsit | 33.52 | Mujore |
| Totali më trust pensional 10%,tatim në burim,pushim vjetor,orë të natës, festa dhe vikendet . | 703.90 | Mujore |
| Fitimi I Kompanise dhe shpenzimet operative | - | Mujore |
| Totali I kostos per nje punetore PA TVSH | 703.90 | Mujore |
| Cmimi I pergjegjshem PA TVSH | 4.00 | Mujore |
| TVSH 18 % | 0.72 | Mujore |
| Cmimi I pergjegjshem ME TVSH per nje ore pune | 4.72 | nje ore pune |
| 38 vendroje * 24 ore ne dite = 912 ore ne dite *30.50 ne muaj=27816 ore ne muaj | 29547.77 orë ne muaj (pas shperndarjes propercionale) | Ore ne muaj |
| Totali I kostos per pike rojet 24 h 38 vendroeje nje muaj | 139,989.27 euro | Mujore |

| **TABELA IIPërshkrimi i aktivitetit/Roje dite Ç'do dite pune 5 dite ne jave (nga ora 07:00-15:00)** | Vlera | Periudha |
|---|---|---|
| Paga Bruto 500.00 euro /176 = 2.84 euro per nje ore pune te rregullt | 500.00 € | Mujore |
| Pushimi vjetor 20 ditë pune(reference ligji I punes 20 dite *8 ore =160 ore ne muaj *2.84euro =454.40 euro / 12 muaj =37.87 | 37.87 € | Mujore |
| Totali I pages me pushim vjetor | 537.87 € | Mujore |
| Trusti pensional 5% i punëdhënsit | 26.89 € | Mujore |

| | | |
|---|---|---|
| Totali më trust pensional | 564.76 € | Mujore |
| Fitimi I Kompanise dhe shpenzimet operative | | Mujore |
| Totali I kostos per nje punetore PA TVSH | 564.76 € | Për një orë |
| Cmimi I pergjegjshem PA TVSH | 3.21 € | Mujore |
| TVSH 18 % | 0.58 € | Mujore |
| Cmimi I pergjegjshem ME TVSH per nje ore pune | 3.79 | Për një orë |
| 22 venderoje * 8 ore ne dite =176 ore ne dite * 22 dite pune ne muaj=3872 ore ne muaj | 4,113.13 h (pas shperndarjes propercionale) | ore nemuaj |
| Totali I kostos per pike rojet Ç'do dite pune 5 dite ne jave 8 h ne dite 22 vendroje nje muaj | € 15,588.77 | Mujore |

| TABELA III Përshkrimi i aktivitetit/Per Vend -Roje per orarin , Roje dite Ç'do dite (nga ora 07:00-15:00) | Vlera | Periudha |
|---|---|---|
| Paga Bruto 500.00 euro /176 = 2.84 euro per nje ore pune te rregullt | 500.00 € | Mujore |
| 8 Orët e festive 50% = 8ore nje dite ne feste *1.42euro =11.36 euro | 11.36 € | Mujore |
| 69.33 Ore vikendi * 50%(8.66 dite mesatare ne vikend * 8 =69.28 ore ne muaj per nje punetor = 69.28ore 1.42euro=98.48 euro ne muaj | 98.48 € | Mujore |
| Pushimi vjetor 20 ditë pune(reference ligji I punes 20 dite *8 ore =160 ore ne muaj *2.84euro =454.40 euro / 12 muaj =37.87 | 37.87 € | Mujore |
| Totali I pages me pushim vjetor | 647.71 € | Mujore |
| Trusti pensional 5% i punëdhënsit | 32.39 € | Mujore |
| Totali më trust pensional | 680.10 € | Mujore |
| Totali I kostos per nje punetore PA TVSH | | Mujore |
| Totali I kostos per nje punetore PA TVSH | 680.10 € | Për një orë |
| TVSH 18 % | 3.86 € | Mujore |
| Cmimi I pergjegjshem ME TVSH per nje ore pune | 0.70 € | Mujore |
| 22 venderoje * 8 ore ne dite =176 ore ne dite * 22 dite pune ne muaj=3872 ore ne muaj | 4.56 | Për një orë |
| 6 venderoje * 8 ore ne dite =48 ore ne dite * 30.50 dite pune ne muaj=1464 ore ne muaj | 1,555.14 (pas shperndarjes propercionale) | Mujore |
| Totali I kostos per pike rojet Roje dite Ç'do dite 8 h ne dite 6 vendroje nje muaj | 7,091.44 € | Mujore |

| TABELA IV Përshkrimi i aktivitetit/12 ore ne dite ç'do dite | Vlera | Periudha |
|---|---|---|
| Paga Bruto 500.00 euro /176 = 2.84 euro per nje ore pune te rregullt | 500.00 € | Mujore |
| Pushimi vjetor 20 ditë pune(reference ligji I punes 20 dite *8 ore =160 ore ne muaj *2.84euro =454.40 euro / 12 muaj =37.87 | 37.87 € | Mujore |
| 12 Orët e festive 50% =12 ore nje dite ne feste *1.42=17.04euro | 17.04 € | Mujore |
| 52 Ore vikendi * 50%(8.66 dite mesatare ne vikend * 12 =103.92 ore ne muaj / 2punetor = 52 ore 1.42euro=73.84 euro ne muaj | 73.84 € | Mujore |
| Totali I pages me pushim vjetor | 628.75 € | Mujore |
| Trusti pensional 5% i punëdhënsit | 31.44 € | Mujore |
| Totali më trust pensional | 660.19 € | Mujore |
| Fitimi I Kompanise | | Mujore |
| Totali I kostos per nje punetore PA TVSH | 660.19 € | Për një orë |
| Cmimi I pergjegjshem PA TVSH | 3.75 € | Mujore |
| TVSH 18 % | 0.68 € | Mujore |

| | | |
|---|---|---|
| Cmimi I pergjegjshem ME TVSH per nje ore pune | 4.43 | Për një orë |
| 2 venderoje*12 ore ne dite =24 ore ne dite *30.50 dite pune ne muaj= | 777.56 | Mujore |
| Totali I kostos per pikerojet 12h ç'do dite 2 vende roje nje muaj | 3,444.59 € (pas shperndarjes propercionale) | Mujore |
| | | |
| Totali I shpenzimeve per mbulimin e kerkesava sipas aneksit 1 specifikimet teknike dhe kerkeses per pagen baze bruto 500.00 euro nje punetor | 165,989.27 € | MUJORE |
| Fondi I oreve sipas kerkeses pershkrimi I cmimit njesia muaj | 35,993.60 | MUJORE |
| Cmimi mesatar I pergjegjshem pa fitim (zero) per nje ore pune me tvsh | € 4.61 | NJE ORE PUNE |

Gjatë fazës së kërkesës sonë për rishqyrtim, ku ne si Operator Ekonomik (OE) pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kemi kërkuar që të trajtohen dhe të vlerësohen në mënyrë të drejtë kërkesat e Dosjes së Tenderit, si dhe të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi, Autoriteti Kontraktues (AK) është përgjigjur si në vijim:

**1. Pragu prej 4.60 €/orë e propozuar nga ju mbivlerëson detyrimin ligjor minimal**
Llogaritja juaj e çmimit minimal prej 4.60 €/orë mbështetet në supozimin se të gjithë punëtorët 24-orësh marrin shtesë vikendi (50%) për çdo fundjavë kalendarike, madje duke aplikuar shtesë vikendi edhe te disa vendroje ditore (Tabela III, orari 07:00–15:00). Ky supozim është në kundërshtim me strukturën reale të organizimit të punës dhe me Ligjin e Punës:

- Sipas Nenit 56.3 të Ligjit Nr. 03/L-212, shtesat për punë gjatë fundjavës, festave dhe **ditëve të lira e përjashtojnë njëra-tjetrën.**
- Vendrojet 24-orëshe operojnë me rotacion 4-punëtorësh dhe me **ditë të lira** (pushim kompensues); rrjedhimisht shtesa e vikendit nuk i takon çdo fundjave kalendarike, por kompensohet me ditë të lira.
- 28 punëtorë janë në orar të rregullt ditor dhe nuk gjenerojnë asnjë shtesë.

Duke marrë parasysh këto, kostoja minimale ligjore reale është dukshëm më e ulët se 4.60 €/orë që pretendoni ju. Pra dyshemeja juaj është e fryrë me një komponent (shtesën e plotë të vikendit) që ligji nuk e kërkon në këtë strukturë.

**Shkelja e Ligjit të Punës nga Autoriteti Kontraktues (AK)**

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke mos trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë pretendimet e paraqitura në kërkesën tonë për rishqyrtim. Në përgjigjen e tij, AK ka konstatuar se ne, si Operator Ekonomik (OE), po tentojmë të imponojmë çmimin mesatar prej 4.60 € si çmim të përgjegjshëm, gjë që nuk përkon me qëllimin dhe përmbajtjen e kërkesës sonë.

Qëllimi i kërkesës sonë ka qenë verifikimi i përputhshmërisë së ofertave me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me legjislacionin në fuqi, veçanërisht me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 03/L-212 i Punës.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, neni 56:

**Neni 56**
**Paga shtesë**

1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.

2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:

2.1. 20 % në orë për kujdestari;

2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;

2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;

2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe

2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.

3. Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra-tjetrën.

4. I punësuari mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi 2. i këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi;

5. Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni. Kjo formë e kompensimit duhet të parashihet në Kontratën e Punës ose në Aktin e Brendshëm të kompanisë.

Në Tabelën I ne kemi specifikuar në mënyrë të qartë mënyrën e kalkulimit të obligimeve ligjore sipas nenit 56 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.
Pra, Autoriteti Kontraktues (AK), në Dosjen e Tenderit, nuk ka kërkuar çmimin për një punëtor, por çmimin për njësi të orës së punës. Rrjedhimisht, përcaktimi i pragut për një ofertë të përgjegjshme duhet të bëhet duke përcaktuar çmimin mesatar të përgjegjshëm për një orë pune, duke përfshirë të gjitha obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji i Punës.
Prandaj, në përgjigjen e tij ndaj pretendimit tonë ankimor lidhur me mbulimin e 28 vendrojeve me orar 8 orë në ditë, prej të cilave 22 janë kërkuar me angazhim 5 ditë në javë, ndërsa 6 të tjera me mbulim 8 orë pa ndërprerje, AK ka bërë një supozim duke konstatuar se këta 28 punëtorë nuk kanë implikime në shtesa sipas Ligjit të Punës.
Një konstatim i tillë nuk është në përputhje me obligimet ligjore që rrjedhin nga organizimi i punës dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit, pasi kalkulimi i çmimit për orë pune duhet të përfshijë të gjitha detyrimet dhe kompensimet e parapara me legjislacionin në fuqi.
Po ashtu, në përgjigjen e AK-së është konstatuar se:
"Vendrojet 24-orëshe operojnë me rotacion 4-punëtorësh dhe me ditë të lira (pushim kompensues); rrjedhimisht shtesa e vikendit nuk i takon çdo fundjave kalendarike, por kompensohet me ditë të lira."
Ky konstatim është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës, pasi organizimi i punës me rotacion dhe pushimi kompensues nuk mund të konsiderohen si zëvendësim automatik i të drejtës për kompensime shtesë për punën e kryer gjatë vikendeve dhe ditëve të festave.

Për këtë çështje ekzistojnë edhe vendime të gjykatave në Republikën e Kosovës, të cilat kanë trajtuar dallimin ndërmjet pushimit kompensues si rezultat i organizimit të ndërrimeve dhe të drejtës së punëtorit për kompensime shtesë sipas Ligjit të Punës.
Prandaj, në vijim paraqitet arsyetimi i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

**Arsyetim lidhur me kompensimin e orëve të punës gjatë vikendit për rojet që punojnë në sistemin 24 orë / 7 ditë në javë (24/7)**

Në rastin e organizimit të punës me ndërrime 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë (24/7), duhet të bëhet dallim i qartë ndërmjet pushimit që rezulton nga organizimi i ndërrimeve dhe kohës faktike gjatë së cilës punëtori ka kryer punë.

Një roje që punon në sistemin 24/7 nuk e humb të drejtën për kompensimin e punës së kryer gjatë vikendit vetëm për faktin se, pas përfundimit të ndërrimit, i caktohen ditë pushimi. Ditët e pushimit janë pasojë e organizimit të orarit të punës dhe shërbejnë për rikuperimin e punëtorit pas kryerjes së detyrës, por ato nuk e ndryshojnë natyrën juridike të orëve të punës të realizuara gjatë ditëve të shtuna dhe të dielave.

Bazuar në përllogaritjen e fondit vjetor të orëve të vikendit:

- Një vit ka 52 vikende;
- Çdo vikend përfshin 48 orë;
- $52 \times 48 = 2,496$ orë vikendi në vit.

Duke qenë se shërbimi 24/7 realizohet nga katër roje, fondi i orëve të vikendit shpërndahet si vijon:

- $2,496 \div 4 = 624$ orë vikendi në vit për një roje;
- $624 \div 12$ muaj $= 52$ orë vikendi mesatarisht në muaj për një roje.

Prandaj, kërkesa që një roje të evidentohet dhe të kompensohet për rreth **52 orë pune gjatë vikendit në muaj** bazohet në shpërndarjen reale të fondit të punës në një shërbim të pandërprerë 24/7 dhe nuk përbën një përfitim shtesë apo të pajustifikuar.

Nga aspekti juridik, pushimi që i takon punëtorit pas përfundimit të ndërrimit nuk mund të konsiderohet si zëvendësim i kompensimit për punën e kryer gjatë vikendit. E drejta për kompensim lind nga fakti se punëtori ka qenë në detyrë dhe ka kryer punë gjatë ditëve të shtuna ose të dielave, ndërsa ditët e pushimit që pasojnë janë vetëm pjesë e organizimit të kohës së punës dhe nuk e shfuqizojnë këtë të drejtë.

Në përputhje me praktikën gjyqësore në kontestet e punës, përfshirë edhe rastin **KI37/22** të Gjykatës Kushtetuese lidhur me kontestin e KEK-ut, të drejtat e punëtorëve duhet të vlerësohen mbi bazën e punës së kryer në mënyrë efektive dhe kompensimit që rrjedh prej saj. Organizimi i ndërrimeve ose caktimi i ditëve të pushimit nuk mund të përdoret si bazë për të mohuar ose eliminuar të drejtën e punëtorit për kompensimin e punës së kryer gjatë vikendit, pasi kjo e drejtë lidhet me kohën faktike të punës dhe jo me mënyrën e organizimit të orarit të punës.

Gjate fazes se kerkeses sone per rishqyrtim ku ne si OE pjesmarres ne kete aktivitet kemi kerkuar qe te trajtohen kerkesat e dosjes se tenderit dhe ligjet ne fuqi. Ak eshte pergjigjur si ne vijim :

**4. Kontratë kornizë me çmim njësi dhe sasi indikative**
Kjo është kontratë publike kornizë. Vetë dosja parashikon shprehimisht se "sasia e parashikuar është vetëm sasi indikative" dhe se "devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është +/-30%", si dhe se "Autoriteti Kontraktues ruan të drejtën e rishikimit të numrit të punëtorëve".
Rrjedhimisht, ofertat krahasohen mbi çmimin për njësi (orë) dhe nuk kërkohet që secila të arrijë një kosto totale fikse. Argumenti juaj që mbështetet në një total të caktuar bie ndesh me natyrën indikative të sasive.

AK, në përgjigjet e tij ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, ka rënë në kundërthënie me konstatimet e veta, pasi në përgjigjen e parë ka vlerësuar se:

kompensohet me ditë të lira.

- 28 punëtorë janë në orar të rregullt ditor dhe nuk gjenerojnë asnjë shtesë.

Ndërsa, në përgjigjen ndaj pretendimit tjetër ankimor, AK është përgjigjur si në vijim:

**4. Kontratë kornizë me çmim njësi dhe sasi indikative**
Kjo është kontratë publike kornizë. Vetë dosja parashikon shprehimisht se "sasia e parashikuar është vetëm sasi indikative" dhe se "devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është +/-30%", si dhe se "Autoriteti Kontraktues ruan të drejtën e rishikimit të numrit të punëtorëve".
Rrjedhimisht, ofertat krahasohen mbi çmimin për njësi (orë) dhe nuk kërkohet që secila të arrijë një kosto totale fikse. Argumenti juaj që mbështetet në një total të caktuar bie ndesh me natyrën indikative të sasive.

Duke vepruar në këtë mënyrë, AK në një moment ka pohuar se kërkesa e Dosjes së Tenderit ka të bëjë me çmimin për njësi të orës së punës, ndërsa në një rast tjetër është bazuar në numrin e 28 punëtorëve.
Po ashtu, fakti që kontrata kornizë, sipas dispozitave ligjore, mund të ketë devijim në vlerë deri në ±30%, nuk duhet të interpretohet në atë mënyrë që Operatorët Ekonomikë (OE) të kenë të drejtë të bëjnë kalkulime vetëm sipas parashikimeve indikative dhe jo sipas kërkesave reale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Një qasje e tillë nuk është në përputhje me parimet e prokurimit publik dhe me obligimin për përgatitjen e ofertave të sakta dhe të bazuara në kërkesat e AK-së.
AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi nuk ka trajtuar ofertat në mënyrë të barabartë dhe objektive, por ka krijuar bindjen se vetëm çmimi më i ulët, pavarësisht mospërputhjeve me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi, është element vendimtar për arsyetimin e vendimit të tij.
Një veprim i tillë përbën shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht:

- Neni 27 – Dosja e Tenderit;
- Neni 28 – Specifikimet Teknike;
- Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Prandaj, ky pretendim ankimor është i bazuar dhe duhet të merret parasysh gjatë shqyrtimit të kërkesës sonë.

Një ofertë e shpërblyer me kontratë, ashtu siç ka vepruar Autoriteti Kontraktues (AK) – QKUK, duke i dhënë kontratën Grupit të Operatorëve Ekonomikë (OE), bie në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik dhe nuk është në përputhje me kërkesat dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht:

- **Neni 1 i Ligjit për Prokurimin Publik – Qëllimi**, pasi nuk garanton përdorimin efikas, transparent dhe ligjor të fondeve publike, nëse kontrata i atribuohet një oferte e cila nuk garanton realizimin e plotë të obligimeve kontraktuale;
- **Neni 7 – Barazia në Trajtim dhe Jo-Diskriminimi**, veçanërisht paragrafi 6, pasi pranimi i një oferte me çmim të ulët, e cila nuk përfshin të gjitha obligimet ligjore dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit, krijon avantazh të padrejtë konkurrues ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë që kanë kalkuluar ofertat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- **Neni 27 – Dosja e Tenderit**, pasi oferta e pranuar duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit;
- **Neni 28 – Specifikimet Teknike**, pasi një çmim i ofertuar që nuk mbulon kostot reale të realizimit të shërbimit mund të ndikojë në pamundësinë e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe kërkesave të kontratës;
- **Neni 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes**, pasi operatori ekonomik duhet të dëshmojë kapacitet real dhe të mjaftueshëm për realizimin e kontratës sipas kërkesave të përcaktuara;
- **Neni 52 – Kriteret për Dhënien e Kontratës**, pasi oferta fituese duhet të jetë ekonomikisht e qëndrueshme dhe të sigurojë realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat e AK-së;
- **Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**, pasi AK ka obligim të kryejë një analizë të plotë dhe objektive të ofertave, përfshirë verifikimin e strukturës së çmimit dhe përputhshmërisë së tij me kërkesat ligjore;
- **Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës**, pasi një ofertë anormalisht e ulët, e cila nuk garanton mbulimin e të gjitha detyrimeve ligjore dhe realizimin e kontratës, nuk mund të konsiderohet ofertë e përgjegjshme;
- **Neni 31 – Ekzekutimi i Kontratave**, pasi pranimi i një çmimi të pamjaftueshëm krijon rrezik për realizimin e kontratës sipas kushteve të përcaktuara dhe për respektimin e obligimeve ligjore ndaj punëtorëve dhe palëve të treta.

Për këto arsye, vlerësimi dhe shpërblimi i kontratës ndaj Grupit të Operatorëve Ekonomikë, pa u verifikuar në mënyrë të plotë që çmimi i ofertuar mbulon të gjitha obligimet ligjore dhe kontraktuale, paraqet shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik dhe të dispozitave relevante të Ligjit për Prokurimin Publik.

Gjithashtu, në përputhje me **Rregulloren Nr. 002/2024, Neni 19, pika 19.16**, specifikimet teknike duhet të jenë të hartuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë se Operatorët Ekonomikë kanë kapacitetin dhe mundësinë reale për të përmbushur kontratën në përputhje me të gjitha kërkesat minimale ligjore dhe teknike.

Kjo nënkupton se gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të ofertave duhet të merret parasysh që çmimi i ofertuar të përfshijë të gjitha kostot e detyrueshme që burojnë nga legjislacioni në fuqi, përfshirë kostot e punës, kompensimet ligjore, obligimet ndaj punëtorëve dhe standardet e kërkuara të ofrimit të shërbimit.

Prandaj, pranimi i një oferte e cila, për shkak të çmimit të ulët, nuk garanton përmbushjen e këtyre obligimeve ligjore dhe teknike, është në kundërshtim me qëllimin e kësaj dispozite dhe me parimet e trajtimit të barabartë, konkurrencës së drejtë dhe realizimit efektiv të kontratës.

Andaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që ta obligojë Autoritetin Kontraktues (AK) të respektojë në përpikëri dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë aktivitet të prokurimit dhe, pas shqyrtimit të pretendimeve tona ankimore, të nxjerrë këtë:

VENDIM

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik "Security Code" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit:

Titulli i kontratës: "RITENDER - Sigurimi Fizik i Objekteve të QKUK-së"
Numri identifikues i aktivitetit të prokurimit: 220/70100-26-3132-2-1-1
Autoriteti Kontraktues: QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS (QKUK).

II. ANULOHET si i pabazuar dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, si dhe:

Të anulohet Njoftimi për Dhënie të Kontratës;
Lënda të kthehet në fazën e rivlerësimit të ofertave, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit;
Autoriteti Kontraktues të obligohet që gjatë procesit të rivlerësimit të analizojë në mënyrë të plotë dhe objektive përputhshmërinë e ofertave, përfshirë kalkulimin e kostove ligjore të punës dhe aftësinë reale të operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratës;
Të merren masat përkatëse ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, në rast se konstatohet se gjatë procesit të vlerësimit janë shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe parimet themelore të prokurimit publik.

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

**Në pajtueshmëri me kërkesat e Dosjes së Tenderit, konkretisht me seksionin e FDT-së dhe kërkesat e përcaktuara në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontratë një Operator Ekonomik i cili ka ofruar një çmim të papërgjegjshëm, i cili nuk mbulon kërkesat e Dosjes së Tenderit.**

**Ne, si Operator Ekonomik, vlerësojmë se do të pësojmë dëme materiale, përfshirë humbje të konsiderueshme në fitimin e parashikuar për këtë kontratë, si pasojë e vlerësimit të padrejtë dhe diskriminues.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- *Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"*
- *Një kopje të vendimit "Njoftimin per dhenie te kontrates*
- *Një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve*
- *Kopja e Kërkesës për rishqyrtim ndaj QKUK*
- *Një kopje e përgjigjes së AK për vendimi- refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së*
- *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 108A të LPP-së*

  *Dokumentet i gjeni ne sistem eprokurimit*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*